



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA FUSHE-ARREZ

KESHILLI



Fushe-Arrez me, 24.01.2024

**RAPORT MBI PUNEN E KESHILLIT TE BASHKISE PER 12-MUJORIN E VITIT 2023**

**Te nderuar keshilltare!**

Keshilli bashkiak, si organi perfaqesues dhe vendimtar, transparencës, qeverisese, ligjshmerite, duke perdorur me ekonomi, eficence dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike te Bashkise.

Vepirmtaria e Keshillit Bashkiak mbeshtetet ne zbatimin e detyrimeve qe burojne nga ligjet, aktet nenligjore ne zbatim te tyre si dhe megullonet e miratuara nga vete keshilli. Gjate vitit 2023 u zhvilluan zgjedhjet vendore dhe kemi nje keshill te pjete me presencen e nje opozite.

Mbledhja e Konsultimit te Keshillit Bashkiak Fushe-Arrez u mbajt e hapur per qytetaret dhe u transmetua ne transparence te pjete livestream ne facebookun e Keshillit Bashkiak.

**Me poshte po paraqesim disa nga aktivitetet e Keshillit Bashkiak Fushe -Arrez per vitin 2023:**

**Vendimarrja:**

Gjate vitit 2023 jane zhvilluar 41 mbledhje komisionesh me pjesmarrjen e 15 keshilltareve.

numri me i madh i mbledhjeve te komisioneve eshte ai komisioneve te perhershme me 40 mbledhje dhe 1 mbledhje per komisionet e tjera.

Per periudhen Janar- Dhjetor 2023, jane marre 39 vendime gjithsej ne Keshillin Bashkiak Fushe Arrez, nga te cilat per 38 vendime eshte siprehur pozitivisht per ligjshmerine Institucioni I Prefektit t Qarkut Shkoder dhe 1 vendim eshte kthyer per rishikqyrtim.

**Vendimet e miratuara jane 39.**

Numrin me te madh te vendimeve e perbejne vendimet qe kane te bejne me bllok ndihmen ekonomike nga fondi i kushtezuar i bllok ndihmes ekonomike i 6%,pastaj vijne vendimet ne lidhje miratimin sipas fazave te programit buxhetor afatmesem 2024-2026.

**Mund te permendim si vendim kryesore gjate vitit te kaluar si:**

- 1.Miratimi i programit buxhetor 2024-2026 sipas fazave.
- 2.Vendimi per ndryshimet ne buxhet .
- 3.Vendimi per te dhenat buxhetore.
- 4.Vendimi per Paketën Fiskale.
- 5.Vendimet per emergjencat civile.
- 6.Vendimet per bursat e nxenesve qe studiojne ne gjimnzet e pergjishme ,si dhe ne shkolla profesionale.
- 7.Vendimet per titujt e nderit.
- 8.Vendimet per emertimet e rrugeve.
- 9.Dhenie pronash ne perdorim.
- 10.Vendimet per prioritetet e investimeve ne vepra publike.

Gjate mbledhjeve te keshillit kane marre pjese 15 keshilltare. Mbledhjet frekuentohen nga 85% e keshilltareve.Ka nje numer te vogel keshilltaresh qe nuk marrin pjese rregullisht ne Mbledhjen e keshillit dhe komisioneve.Edhe vonesat ne fillimin e mbledhjeve mbeten nje problem qe duhet zgjidhur ne vazhdimeri, per arsye te largesise ,pasi jetojne ne zona te thella dhe ka mungese te transportit interurban.

I gjithe dokumentacioni projekt vendimeve te shqyrtuara gjate mledhjeve te Keshillit eshte publikuar ne faqen web te keshillit per tu dhene mundesi qytetareve te njihen me to . Ne rregjistrin online per transparencen e mbledhjeve te keshillit jane dokumentuara te gjitha informacionet mbi mbledhjet duke filluar nga thirrja e mbledhjes,oraret e mbjatjes,videot e mbledhjes dhe procesverbalet e tyre. Mbledhjet e Keshillit jane transmetuar shumica dermuese online ne facebook te Keshillit Bashkiak dhe ne mediat locale.Duke filluar nga ky vit Keshilli Bashkiak do te vazhdoje te transmetoje mbledhjet livestream ne facebook te mundesuara nga bashkepunimi me projektin Bashki te Forta (financuar nga QEveria Zvicerane). Kjo I jep Keshillit Bashkiak nje pavaresi ne transmetimin paderprerje livestream te mbledhjeve dhe I krijon vmundesi te jete transparent ne lidhje me te gjitha vendimet qe merr dhe problemet qe trajton per ti ardhur ne ndihme qytetareve.

**Kerkesat dhe ankesat e qytetareve**

Ne Keshillin Bashkiak Fushe-Arrez per periudhen Janar-Dhjetor 2023 jane regjistruar tete kerkesa nga te cilat rreth 60% e tyre eshte trajtuar ne Keshill Bashkiak , ndersa pjesa tjeter eshte trajtuar

shkreerisht. Pjesa me e madhe e kërkesave ka qene per hapje rrugesh, rikonstruksion te shkollave, etj. Ka shume pak ankesa nga qytetaret, me te cilet duhet shtuar komunikimi per ti ftuar ato te adresojne shqetesimet e tyre tek Keshilli Bashkiak.

Gjate kesaj periu dhe nuk ka patur peticion dhe nisma te qytetareve te depozituara ne Keshill. Keshilli bashkiak ne kordinim me Bashkine do ti jape pergjigje te gjitha shqetesimeve te qytetareve me mundesite qe ka ne dispozicion. Te gjitha kërkesat dhe ankesat jane te publikuara ne rregjistrin online te kerkese-ankesave ne faqen web te Keshillit Bashkiak.

### **Konsultimi me publikun**

Keshilli Bashkiak i ka kushtuar vemendje te veqane degjesave publike per preojekt aktet per te cilat kerkohet nga ligji. Jane zhvilluar shtate degjesa publike per tre projekt akte, Plani lokal per veprimin e zhurmes ne mjedis te Bashkise, per miratimin e taksave dhe tarifave vendore ne Bashkine Fushe – Arrez, Mbi Miratimin e Projektbuxhetit te Pare Afatmesem 2024-2026 ne Bashkine Fushe-Arrez. Ne degjesa moren pjese gjithsej 280 qytetare, 200 meshkuj dhe 80 femra, qytetar, biznese, grupe interesi, anetar keshilli konkretisht u dhane rreth 15 rekomandime ne degjesa publike nga te cilat 70% u moren parasysh nga bashkia. Te gjitha informacionet per konsultimet publike jane publikuara ne regjistrin online per konsultimet me publikun ne faqen web te keshillit bashkiak.

### **Aktivitetet kryesore te Keshillit**

Gjate vitit 2023 ne bashkepunim me Projektin Bashki te Forta eshte realizuar nja trajnim 2 ditor per keshilltaret ne ambjentet e Keshillit Bashkiak.

Keshilli Bashkiak Fushe -Arrez per aktivitetet e vitit 2023 kishte planifikuar te shpenzoje 400.000 leke dhe nga kjo shume ka shpenzuar 41% te buxhetit te planifikuar. Pjesa me e madhe e buxhetit eshte shpenzuar per montimin pajisjeve te transmetimit te mbledhjeve te Keshillit Bashkiak livestream ne facebook, per mbajtjen e degjesave publike per projekt akte te ndryshme ,shpenzime per trajnimin e keshilltareve ne bashkepunim me Projektin Bashki te Forta, Shpenzime per kancelari dhe shpenzime te tjera per mbarevajtjen e aktivitetete te Keshillit Bashkiak. Nga keto shpenzime jane te perjashtuara shpenzimet per honoraret e keshilltarve.

Keshilli Bashkiak ka miratuar Planin e Aktiviteteve, Vendimmarrjes dhe Konsultimeve per vitin 2024 te shoqeruar me nje buxhet te mjaftueshem.

Keshilli Bashkiak ka marre pjese ne aktivite te organizuara per veprimtari te ndryshme si psh. takim me rinine per evidentimin e problemeve qe ata kane, takim me grate e qytetit per te degjuar kërkesat e tyre, takim me bizneset per ju ofruar kushtet pet e cilat ato kane nevojë.

Keshilli Bashkiak kete vit ka organizuar 2 fushata advokimi ne facebookun e Keshillit Bashkiak per te nxitur pjesemarrjen e qytetareve ne vendimarrje, duke i ftuar qytetaret te behen pjese aktive ne dialogun me qeverisjen vendore, te perdorin instrumentet e keshillit per te zgjidhur problemet e tyre

dhe per ti kerkuar llogari apo te zgjidhin problemet e tyre nepermjet kerkese/ankesave qe mund te drejtojne te Keshilli,mund te ndjekin mbledhjet online apo te marrin pjese ne degjesat publike per projekt akte te ndryshme apo per buxhetin e Bashkise.

SEKRETARI

